




TË ARDHURA QË LULËZOJNË

Investoni në fondin që vë
në lëvizje kursimet tuaja

Raport Muaji Korrik 2025

Informacion bazë

Administrimi i Fondit	Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	LEK
Datë Lancimi	01 Mars 2012
Vlera fillestare e kuotës	1,000
Shuma fillestare minimale	5,000
Shuma minimale pasuese	1,000

Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të maksimizojë kthimin nga investimi, duke synuar në të njëjtën kohë ruajtjen e kapitalit të investitorit dhe sigurimin e likuiditetit të nevojshëm.

Asetet e fondit janë të investuara në bono thesari dhe obligacione të emetuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Fondi është i përshtatshëm për individë dhe subjekte juridike të cilët mendojnë se objektivi i investimit i Fondit përputhet me kërkesat dhe pritshmëritë e tyre.

Komisionet dhe Tarifat

Tarifë në hyrje	0%
Tarifë në dalje	0%
Tarifë Administrimi në vit	Deri ne 1.15% e vleres neto te aseteve
Tarifa te tjera te vazhdueshme	Referojuni prospektit te fondit
Komisione/tarifa e vazhdueshme	1.27% per vitin 2024
Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta	Referojuni informacionit ne deget e RBAL


Shifra e tarifës së vazhdueshme 1.27% mbështetet në shpenzimet për vitin e mbyllur më 31.12.2024. Kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Tarifa totale e vazhdueshme nuk mund të kalojë maksimumin prej 1.4% ne vit te vlerës neto të aseteve te fondit.

Kostot e transaksioneve janë sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese dhe nuk përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por ato i ngarkohen Fondit.

Profili i Riskut dhe Përfitimit

Risk i ulët
Përfitimet tipike më të ulëta

Risk i lartë
Përfitimet tipike më të larta



Fondi Raiffeisen Prestigj është në kategorinë e dytë të Profilit të Riskut dhe Perfitimit.

Treguesi i riskut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk.


Ky tregues ka për qëllim tju informojë mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.

Të dhëna për Fondin në 31.07.2025

Vlera Neto e Aseteve	43,108,039,718
Numri i investitoreve	33,667
Çmimi i Kuotes	1,751.3095
*Kthimi vjetor neto nga investimi (31.07.2024 – 31.07.2025)	4.90%

*Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera të vazhdueshme zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

Struktura e portofolit të investimeve në 31 Korrik 2025



Në kuadër të politikës së investimit të fondit Prestigj, investimet do të kryhen kryesisht në bono dhe obligacione thesari, të emetuara ose garantuara nga Qeveria shqiptare, përmes pjesëmarrjes në ankandet e tregut primar apo transaksioneve në tregun sekondar. Bonot e thesarit 12 mujore emetohen dy herë në muaj; Obligacionet 2 vjeçare një herë në muaj; 10 dhe 15 vjeçare janë me të rralla, afërsisht një herë në tre muaj. Qeveria organizon ankande të obligacioneve referencë 5 dhe 3-vjeçare me frekuencë një herë në muaj për secilin maturitet.

<i>Instrumenti</i>	<i>Ne % të Aseteve të Fondit</i>
Depozita, Llogari rrjedhese & Rev Repo	9.76%
Bono Thesari	24.24%
Obligacione Thesari	65.99%

Strategjia e investimeve është e fokusuar në tituj të Qeverisë Shqiptare, por përveç këtyre investimeve, Fondi mban një pjesë të asetëve në depozita afatshkurtra për të plotësuar në çdo kohë nevojat për likuiditet të investitoreve.


Vlera neto e asetëve të fondit është në nivelin e LEK 43.1 miliardë në datë 31 Korrik 2025.

Zhvillimet dhe ecuria e normave te interesit te titujve te Qeverise Shqiptare gjate muajit Korrik

Banka e Shqipërisë, në mbledhjen e fundit të organizuar në Korrik, vendosi të ulë normën bazë të interesit me 25 pikë bazë, e cila aktualisht është në nivelin 2.50%. Nderkohe, norma e inflacionit mbetet në nivele të ulëta dhe nën kontroll sipas Bankës së Shqipërisë. Asetet e Fondit Prestigj janë të investuara vetëm në bono dhe obligacione të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe për këtë arsye fondi është i ekspozuar ndaj ndryshimeve në normat e interesit të këtyre titujve.

Normat e interesit të titujve të emetuar nga Qeveria Shqiptare kanë ndjekur një trend rritës gjatë muajit Korrik përveç bonos 12 mujore. Yieldi i Bonos së Thesarit 12-mujore rezultoi në 2.682% duke rënë me 0.08% në krahasim me ankandin e muajit Qershor. Përsa i përket obligacioneve në krahasim me ankandet e fundit: Yieldi i obligacionit 2 vjeçar rezultoi në 3.08%, duke u rritur me 0.23% në krahasim me ankandin paraardhës; Yieldi i obligacionit reference 3 vjeçar rezultoi në 3.338% duke u rritur me 0.33%; Yieldi i obligacionit reference 5 vjeçar rezultoi në 3.733% duke u rritur me 0.23%; Yieldi i obligacionit 7 vjeçar rezultoi në 4.29% duke u rritur me 0.32% dhe Yieldi i obligacionit 10 vjeçar rezultoi në 5.05% duke u rritur me 0.35%.

Grafiket më poshtë japin një pasqyrë të ecurisë së normave të interesit të bonove dhe obligacioneve të thesarit të emetuar nga Qeveria Shqiptare gjatë periudhës 1-vjeçare Korrik 2024 – Korrik 2025. Për obligacionet reference 3 dhe 5 vjeçare janë paraqitur yield-et fikse të përlogaritura nga kuotimet e kontributoreve në fund të muajit Korrik.




Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri në 31 Korrik 2025

Kthimi vjetor neto për periudhën 31 Korrik 2024 – 31 Korrik 2025 është 4.90%.

Çmimi i kuotës së fondit Prestigj në muajin Korrik ka rënë me **-0.19%**. Rritja e normave të interesit për obligacionet e qeverisë shqiptare ka ndikuar negativisht në portofolin e investimeve të fondit Prestigj.


Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon në varesi të kushteve të tregut, sic janë ndryshimet e normave të interesit të titujve të borxhit të emetuar nga Qeveria Shqiptare. Kështu kur normat e interesit në treg rriten, vlera e titujve të portofolit ulët dhe për rrjedhojë ulët dhe norma e kthimit për periudhën e kaluar. E kundërta ndodh kur normat e interesit ulen. Për pasojë, çmimi i kuotës mund të jetë i luhatshëm. Luhatshmeria është pjesë e natyrshme e fondeve të investimit dhe eliminimi i saj është i pamundur, kështu çmimi i kuotës mund edhe të bjere, jo vetëm të rritet.

Ecuria e çmimit të kuotës Fondi Raiffeisen Prestigj



Ne dt. 31 Korrik 2025	1 Vit	2 Vjet	3 Vjet	5 Vjet	8 Vjet	10 Vjet	Qe nga lancimi i fondit (1 Mars 2012)
Ne % kthim vjetor i periudhes (p.a.)	4.90%	4.11%	3.93%	2.67%	2.58%	3.46%	4.26%

Kthimi vjetor historik i Fondit Raiffeisen Prestigj per çdo vit



Investitorët e fondit Prestigj dhe të gjithë fondeve të administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen të kenë një horizont sa më të gjatë investimi për të përfituar një kthim optimal nga investimi dhe në këtë mënyrë në periudhë afatmesme apo afatgjatë të kenë mundësi të rikuperojnë edhe efektet negative të krijuara afatshkurter.

Investitorët inkurajohen që të ruajnë investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qëndrimit në fond, sepse në këtë mënyrë nuk do të rrezikojnë të dalin nga fondi në momentin e gabuar për investimin e tyre.

Të dhënat për kthimin nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjere numerike, janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analize të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen. Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit. Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen INVEST sh.a., në website www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.